



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

Tiranë, më 6.11.2018

(Dokument Parlamentar)

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN**

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËFINANCIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, DHE FONDIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR POPULLSINË”

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në mbledhjen e datës 6 nëntor 2018, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin, “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit, ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë”, është nismë e Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes së bashkëfinancimit, e cila është miratuar me vendimin nr.420, datë 4.7.2018, të Këshillit të Ministrave.

Ky projektligj hartohet në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës. Procedurat e miratimit janë në përputhje me nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” dhe projektligji hartohet jashtë programit analitik të akteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Projektligji është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkërendim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të cilat janë shprehur dakord për këtë marrëveshje bashkëfinancimi.

Në komision, për të prezantuar projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e deputetëve, ishte i pranishme zv. Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

Të ftuarit në komision, prezantuan të gjithë ecurinë dhe rezultatet e studimit për çrregullimin i vëmendjes së deficitit të hiperaktivitetit (ADHS). Kryerja e plotë e studimit ADHS 2017-2018 kërkon një buxhet total prej 167 111 153 lekësh.

Duke marrë në konsideratë kontributet e partnerëve ndërkombëtarë (SDC/HAP, UNFPA, UNICEF, UN Ëomen) dhe të institucioneve kombëtare (ISHP dhe INSTAT), shpenzimet e kryera, parashikimet e shpenzimeve deri në përfundimin me sukses të studimit (duke marrë parasysh edhe ndryshimet në kurset e këmbimit valutor nga të paktën tri monedha (CHF, USD, ALL), rezulton se fondi i pambuluar për përfundimin e ADHS-së është në total 300 000 USD (ose 33 500 000 lekë.)

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të mbulojë 22 500 000 (njëzet e dy milionë e pesëqind mijë) lekë të këtij fondi të pambuluar, ndërsa UNFPA, në kuadër të marrëveshjes së bashkëfinancimit për këtë studim, krahas kontributit të dhënë, merr përsipër të mbulojë diferencën prej 11 000 000 (njëmbëdhjetë milionë) lekësh.

Nëpërmjet pyetjeve dhe diskutimeve në mbledhjen e Komisionit, deputetët e komisionit u informuan për risitë të këtij projektligji, i cili i hap rrugë përfundimtare studimit për ADHS-në dhe:

- realizohet në një kampion të madh dhe përfaqësues të popullatës dhe, si rrjedhojë, rezultatet e tij janë përfaqësuese për gjithë popullatën shqiptare;
- ofron të dhëna të vlefshme demografike dhe shëndetësore për shumë grupmosha dhe kategori të rëndësishme të popullatës – të dhëna që nuk ofrohen nga të dhënat administrative dhe nga studime të tjera;
- përfshin grupmoshat dhe kategoritë, si: fëmijët e moshës 0-5 vjeç, gratë shtatzëna, gratë e moshës riprodhuese, individët në moshë madhore të të dyja gjinive 15-59 vjeç.
- siguron informacion për vlerësimin e programeve ekzistuese në vendin tonë.

Nga përfaqësuesit e ministrisë, të ftuar në komision, u prezantuan dhe rezultatet dhe ecuria e studimit.

Të dhënat e studimit të parë të ADHS-së të realizuara në periudhën 2008- 2009 janë përdorur gjerësisht për hartimin e dokumenteve kryesore strategjike dhe politike, si: Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2016-2020; Programi Kombëtar për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Infektive në Shqipëri 2016-2020; Plani i Veprimit të Promovimit Shëndetësor 2017-2021; Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe Riprodhues 2017-2021.

Gjithashtu, të dhënat e përfuara nga raundi i parë i ADHS-së janë reflektuar edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020, miratuar nga Këshilli i Ministrave në vitin 2016.

Ky projektligj nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të përmbushë me fondet e saj buxhetore mbulimin e fondit të nevojshëm prej 22.5 (njëzet e dy pikë pesë) milionë lekësh.

Deputetët e opozitës, anëtar në këtë komision, nuk morën pjesë në mbledhjen e komisionit.

Pas shqyrtimit, projektligji u miratua në parim, nen për nen dhe në tërësi me votat e anëtarëve të pranishëm në komision dhe i përcillet për shqyrtim komisionit përgjegjes.

K R Y E T A R E

Elisa SPIROPALI